



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial
Council

Datë: 22 mars 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 dhe 16 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit si dhe Vendimin KPK/Nr.268/2024, të datës 19 mars 2024, shpall:

SHPLLJE E BRENDSHME

Për transferimin e përhershëm të gjashtë (6) Prokurorëve të Shtetit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

- I. Prokurori i Shtetit mund të transferohet nga Departamenti i Prokurorisë Themelore në Departamentin e Prokurorisë tjetër Themelore të nivelit të njëjtë.
- II. Prokurorët e Shtetit duhet t'i plotësojnë kriteret për transferim të përhershëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, si në vijim:
 - Të jenë prokuror me mandat të përhershëm;
 - Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përjashtimisht vërejtjes jopublike dhe qortimit, përveç nëse transferimi është bërë me vendim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, si masë disiplinore;
 - Të kenë vlerësim të performancës të mjaftueshëm ose më të lartë.
- III. Komisioni merr parasysh me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm edhe përvojën e punës dhe vendbanimin e kandidatit.
- IV. Me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm merret edhe mendim i kryeprokurorit të prokurorisë, nga e cila kërkohet transferimi.
- V. Kandidati që aplikon për Transferim të përhershëm, duhet t'i plotësoj formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit si dhe t'i bashkëngjisin dokumentet si në vijim:
 - Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre (3) vitet e fundit;

- Dokumentet apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese të përbashkëta.

VI. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.

VII. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 25 mars 2024 deri më 08 prill 2024.

VIII. Kërkesa duhet të dorëzohet tek Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e gjashtë (6), ndërtesa e Prokurorit të Shtetit, Rruga "Luan Haradinaj", Prishtinë, zyra numër 602, të mbyllura me zarf ose me postë.

¹ Prokurorët të cilët aplikojnë për transferim dhe avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit, të cilin mund ta gjejnë <https://www.prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkangjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.